

20192443803

LIGJ PËR GARANCI TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT TË OBLIGIMEVE SIPAS MARRËVESHJES PËR HUA PËR FINANCIM PLOTËSUES PËR PROJEKTIN PËR NDËRTIMIN E AUTOSTRADËS - AKSI RRUGOR KËRÇOVË - OHËR, QË DO TË LIDHET NDËRMJET BANKËS EKSPORT - IMPORT TË KINËS DHE NDËRMARRJES PUBLIKE PËR RRUGË SHTETËRORE

Neni 1

Republika e Maqedonisë së Veriut e garanton përmbushjen e obligimeve dhe plotësimin e dispozitave të Marrëveshjes për hua për financim plotësues të Projektit për ndërtimin e Autostradës - aksi rrugor Kërçovë - Ohër që do të lidhet ndërmjet Bankës Eksport - Import të Kinës dhe Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore në shumë prej 179.694.572,21 USD, nëse Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore nuk i plotëson dhe nuk i servison obligimet nga Marrëveshja për hua.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga neni 1 i këtij ligji përcaktohen me Marrëveshjen për hua për financim plotësues të Projektit për ndërtimin e Autostradës - aksi rrugor Kërçovë – Ohër, që do të lidhet ndërmjet Bankës Eksport - Import të Kinës dhe Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore për Projektin për ndërtimin e Autostradës - aksi rrugor Kërçovë – Ohër.

Neni 3

Kushtet dhe mënyra e aktivizimit të garancisë nga neni 1 i këtij ligji, përcaktohen me Letër të garancisë të cilën në emër të Republikës së Maqedonisë së Veriut do ta nënshkruajë ministri i Financave.

Ministri i Drejtësisë do të japë mendim juridik për vlefshmërinë juridike të Letrës së garancisë nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 4

Të gjitha obligimet që dalin nga Marrëveshja për hua nga neni 1 i këtij ligji, si dhe servisimin e huas do t'i kryejë Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore nga të hyrat që i realizon, në afate dhe kushte të përcaktuara në Marrëveshje për hua.

Neni 5

Afati i pagesës së huas nga neni 1 i këtij ligji është 20 vite, me grejs periudhë të përfshirë prej pesë vitesh.

Shkalla e kamatës është shkallë fikse e kamatës dhe do të jetë 2% në nivel vjetor për tërë kohëzgjatjen e huas.

Huaja do të paguhet në 30 këste të barabarta gjysmëvjetore që arrijnë për pagesë më 20 prill dhe 20 tetor çdo vit.

Neni 6

Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore do t'i pagajë Bankës Eksport - Import të Kinës provizion të njëhershëm në lartësi prej 0,25% të shumës së huas, në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes për hua nga neni 1 i këtij ligji.

Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore do t'i pagajë Bankës Eksport - Import të Kinës provizion në lartësi prej 0,25% të shumës së patërhequr të huas së huas në nivel vjetor, duke filluar nga dita e 30 nga data e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes për hua nga neni 1 i këtij ligji.

Neni 7

Për rregullimin e të drejtave dhe obligimeve të ndërsjella që dalin nga Marrëveshja për hua nga neni 1 i këtij ligji dhe Letra e garancisë, Ministria e Financave dhe Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore do të lidhin marrëveshje të veçantë.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.